



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES
INSTITUTI I GJEOGRAFISE DHE INFRASTRUKTURES USHTARAKE

"PERMIRESIMI I INFRASTRUKTURES DHE RIKONSTRUKSIONI I BANKINES T"


RELACION DHE SPECIFIKIME TEKNIKE ARKITEKTONIKE

Korrik 2026



1. Punimet qe do kryhen nga ana ndertimore :

- Në kuadër të rikonstruksionit të bankinës do të instalohen fenderë mbrojtës tip **DD**, të cilët shërbejnë për amortizimin e energjisë së goditjes gjatë kontaktit të mjeteve lundruese me bankinën, duke mbrojtur si strukturën e saj ashtu edhe anijet nga dëmtimet mekanike.
- Fenderi tip **DD** përbëhet nga një profil gome me seksion në formë "**D**" dhe me zgavër të brendshme, e cila rrit elasticitetin dhe aftësinë për absorbimin e energjisë gjatë impaktit. Ky konfigurim siguron një shpërndarje më efektive të ngarkesave dinamike dhe redukton forcat që transmetohen në strukturën e bankinës.
- Elementët do të prodhohen me proces ekstruzioni nga gomë natyrale ose sintetike me rezistencë të lartë ndaj ujit të detit, rrezatimit ultraviolet (UV), ozonit dhe kushteve atmosferike detare, duke garantuar jetëgjatësi dhe performancë të qëndrueshme në shërbim.
- Montimi i fenderëve do të realizohet nëpërmjet bulonave dhe vidave të fiksimit, të vendosura në pjesën e pasme të sheshtë të profilit, duke siguruar një lidhje të fortë me strukturën mbajtëse dhe duke lehtësuar operacionet e mirëmbajtjes ose zëvendësimit në të ardhmen. Skajet e fenderëve mund të realizohen me prerje të pjerrët (*bevel*) sipas kërkesave të projektit dhe detajeve të zbatimi



- Fenderët do të vendosen në segmente të veçanta, me distanca të përcaktuara sipas projektit, dhe me orientim të pjerrët, duke formuar një kënd rreth 70° me planin

horizontal të bankinës. Kjo mënyrë vendosjeje rrit sipërfaqen efektive të kontaktit me mjetet lundruese, përmirëson shpërndarjen e forcave të goditjes dhe siguron mbrojtje më efektive gjatë manovrave të afrimit dhe akostimit.

- Zgjidhja e propozuar garanton mbrojtje të besueshme të bankinës dhe mjeteve lundruese, ul kostot e mirëmbajtjes së strukturës dhe rrit sigurinë gjatë operacioneve portuale.

Punoi : ark. Kleogena Kateshi

